



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**Anr.233 /2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Hasan Shala dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Malishevë, paraqitur kundër Iniciativës Qytetare e Malishevës (IQM), për shkak të dëmtimit të posterave të kandidatit për Kryetar Komune në Malishevë nga radhët e PDK-së, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 25.10.2013, mori këtë:

**VENDIM**

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Malishevë.

**Arsyetim**

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 10.10.2013, nga subjekti politik PDK dega në Malishevë, me të cilën pretendohet se gjatë mbrëmjes të datës 9.10.2013 rreth orës 22:00-22:30, në rrugën “ Imer Krasniqi” në Malishevë janë dëmtuar gjashtë postera të kandidatit nga radhët e PDK-së që është i kandiduar për Kryetar Komune Isni Kilaj. Po ashtu parashtruesi i ankesës thekson se në të njëjtën mbrëmje në rrugën “Rilindja Kombëtare” janë dëmtuar gjashtë postera dhe dy pano të PDK-së. Parashtruesi i ankesës pretendon se në bazë të informacioneve të tyre dëmtimi i posterave është bërë nga Artan Mazreku, anëtar i subjektit politik IQM, dhe me këtë është bërë shkelje e Kodit të Mirësjelljes dhe Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur disa fotografi si dëshmi.

PZAP-i, nëpërmjet emailit e informoi subjektin politik Iniciativa Qytetare Malishevë (IQM), në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, se më datë 10.10.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 11.10.2013, në ora 16:00.

PZAP-i, mori përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik Iniciativa Qytetare Malishevë (IQM) sipas afatit të caktuar, ku subjekti politik IQM mohon pretendimet e ankuesit dhe thekson se akuzat në drejtim të subjektit tonë politik janë të pavërteta sepse ne nuk kemi mundur të identifikojmë personi e apostrofuat nga PDK, Artan Mazreku dhe këto akuza janë me qëllim të caktuar dhe nxitjes së urrejtjes dhe prishjes së fushatës parazgjedhore.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

**ankesa është e pabazuar**

PZAP-i, vlerësoi pretendimet ankimore, përgjigjen në ankesë dhe konstatoi se pretendimet ankimore janë të pa bazuara dhe të pa argumentuara, sepse nga dëshmitë e ofruara nga parashtruesi i ankesës nuk janë dëshmi bindëse me të cilën vihet në dyshim se është kryer një veprim i ndaluar dhe nuk janë të mjaftueshëm për të vërtetuar kryesin e supozuar të shkeljes. Andaj PZAP-i ,konstatoi se një pretendim i tillë është i përgjithshëm dhe i pa qartë për tu vërtetuar, prandaj duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së,dhe nenit 115.1 lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia në Prishtinë**

Anr. 233/2013 më datën 25.10.2013



Këshillë Juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*